



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVES

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Nenit 33 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës (2024), Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018, për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi I, MASHT) 7/2018 e UA 01/2018, për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës, në mbledhjen e datës 29.09.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES DHE RIZGJEDHJES SË PUNËTORËVE SHKENCORË DHE HULUMTUESVE NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Neni 1 (Qëllimi)

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, në thirrjet: hulumtues (asistent i ri), hulumtues i pavarur (asistent), bashkëpunëtor shkencor (profesor asistent), bashkëpunëtor i lartë shkencor (profesor i asociuar) dhe këshilltar shkencor (profesor i rregullt).

Neni 2 Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit

1. Në pajtim me nenin 43 të Statutit të IPK-së dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore, nr. 04/L-135 të datës 28.03.2013, përkatësisht nenet: 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35, personeli shkencor dhe hulumtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës përbëhet nga:
 - 1.1. hulumtues (e barasvlefshme me thirrjen asistent i ri),
 - 1.2. hulumtues i pavarur (e barasvlefshme me thirrjen asistent),
 - 1.3. bashkëpunëtor shkencor (e barasvlefshme me thirrjen profesor asistent),

- 1.4. bashkëpunëtor i lartë shkencor (e barasvlefshme me thirrjen profesor i asociuar) dhe
- 1.5. këshilltar shkencor (e barasvlefshme me thirrjen profesor i rregullt).
2. Të punësuarit që merren me punë kërkimore-shkencore në Institut, dhe që i plotësojnë kushtet e parapara me legjislacion në fuqi, dhe me këtë Statut, zgjidhen bashkëpunëtorë shkencorë profesionalë, hulumtues dhe punëtorë shkencorë.
3. Titujt hulumtuesë janë:
 - 3.1. hulumtues;
 - 3.2. hulumtues i pavarur.
4. Titujt shkencorë janë:
 - 4.1. Bashkëpunëtor shkencor;
 - 4.2. Bashkëpunëtor i lartë shkencor;
 - 4.3. Këshilltar shkencor.

Neni 3

Zgjedhja dhe rizgjedhja në titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Zgjedhja dhe rizgjedhja e kandidatëve në titujt përkatës, bëhet në bazë të kriterëve dhe të kërkesave të parapara me Statutin e IPK-së të paraqitut në shtojcat e kësaj rregulloreje.
2. Procedura recensuese për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt shkencorë dhe hulumtues, mbështetet në dëshmitë dhe kriteret që për aktivitetet si në vijim:
 - 2.1. Aktiviteti kërkimor-shkencor dhe profesional – shtojca I;
 - 2.2. Aktivitetet e tjera kërkimore dhe shkencore – shtojca II.
3. Shtojcat I dhe II janë pjesë përbërëse të rregullores.
4. Zgjedhja dhe rizgjedhja në titujt shkencor dhe hulumtues bëhet përmes konkursit publik të shpallur nga IPK, siç është paraparë me Statut.

Neni 4

Puna dhe kontributi shkencor dhe profesional

1. Puna dhe kontributi shkencor e profesional i personelit shkencor dhe hulumtues të IPK-së, me rastin e zgjedhjes dhe rizgjedhjes, vlerësohet sipas udhëzimeve në shtojcat I dhe II të kësaj Rregulloreje.
2. Puna dhe kontributi shkencor e profesional që duhet të vlerësohet me rastin e zgjedhjes dhe rizgjedhjes përfshinë:
 - 2.1. Punimet shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare.
 - 2.1.1. Në rastet kur në një punim shkencor kontribuuesi është autor i dytë, kontributi i tij/saj vlerësohet me 70% të pikëve të parapara për punimin sipas pikës 2.1.

- 2.2. Monografitë shkencore:
 - 2.2.1. Monografia shkencore është e barasvlershme me dy punime shkencore sipas pikës 2.1.,
 - 2.2.2. Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës i publikuar si botim i veçantë.
- 2.3. Botimet e veçanta jomonografi:
 - 2.3.1. Botimi i veçantë jomonografi, është i barasvlefshëm me një (1) punim shkencor.
 - 2.3.2. Botim me përmbledhje të punimeve, recensioneve, biografive dhe dokumenteve tjera shkencore është i barasvlefshëm me 50% të pikëve me një punim në revista ndërkombëtare sipas pikës 2.1.
 - 2.3.3. Vëllim me dokumente dhe udhëzime metodike-didaktike është i barasvlefshëm me 50% të pikëve të një punimi shkencor të botuar në revista ndërkombëtare sipas pikës 2.1.
- 2.4. Punimet dhe prezantimet në konferenca shkencore.
 - 2.4.1. Për vlerësim janë të nevojshme së paku tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- 2.5. Udhëheqja dhe kryerja e projekteve zhvillimore, shkencore e profesionale të fushës që lidhen direkt me veprimtarinë e IPK-së të financuara nga IPK, MASHTI apo ndonjë mekanizëm vendor qeveritar apo i BE-së.
 - 2.5.1. Për vlerësim është e nevojshme të dëshmohen së paku dy (2) projekte.
- 2.6. Punimet shkencore të botuara nga institucionet shkencore, vendore apo ndërkombëtare, të pajisura me ISSN;
 - 2.6.1. Një punim i botuar në revista, vendore apo ndërkombëtare të pajisura me ISSN, vlerësohet me 50% të pikëve me një punim në revista ndërkombëtare sipas pikës 2.1;
- 2.7. Evidentimi i kontributeve shkencore të përmendura në këtë nen bëhet sipas pikave të shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.
3. Artikujt shkencor të hulumtuesve të IPK botuar në revistën e Institutit Pedagogjik të Kosovës nga numri i parë (viti 2010) do të barasvlerësohen me 1 punim në revista ndërkombëtare të cilat janë të indeksuara në bazat akademike.
 - 3.1. Njohja e punimit për zgjedhje/rizgjedhje aplikohet sipas parimit që tri punime (për pozita e hulumtuesve) përkatësisht katër punime (për pozita e bashkëpunëtorëve shkencor) në revistën e Institutit Pedagogjik të Kosovës barasvlerësohen me 1 punim sipas kushteve në paragrafin A 2.1 të shtojcës I të kësaj rregulloreje.
 - 3.2. Kumtesat, referatat dhe materialet e prezantuara në konferenca nuk konsiderohen si punime shkencore dhe nuk i nënshtrohen vlerësimit sipas kërkesave në shtojcën I të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Zgjedhja në thirrjen hulumtues

1. Në pajtim me nenin 45 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për titullin e hulumtuesit (asistent i ri), në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar studimet bachelor dhe ato master në drejtimin përkatës;
 - 1.2. Të jetë jo më i vjetër se 27 vjet kur zgjedhët për herë të parë.
 - 1.3. Të ketë notën mesatare së paku tetë (8) në studimet bachelor dhe master.
2. Thirrja hulumtues është me mandat 3 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
3. Hulumtuesi mund të zgjedhet në titull më të lartë, hulumues i pavarur, pas tri viteve, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me Nenin 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen hulumtues i pavarur

1. Në pajtim me nenin 45 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për titullin e hulumtuesit të pavarur (asistent), në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar studimet master në drejtimin përkatës;
 - 1.2. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në programe relevante me fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
 - 1.3. Për programet e doktoratës jashtë Republikës së Kosovës, me rastin e aplikimit për zgjedhje/avancim në këtë thirrje, kandidati ofron dëshmi nga qendra NARIC në MASHTI se programi është i transferueshëm dhe njihet/barasvlerësohet në Kosovë.
 - 1.4. Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara;
 - 1.5. Të ketë pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - 1.6. Të dëshmojë pjesëmarrjen dhe kontributin në projekte kërkimore-shkencore;
2. Thirrja hulumtues i pavarur është me mandat 3 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
3. Hulumtuesi i pavarur mund të zgjedhet në titull më të lartë, bashkëpunëtor shkencor, pas tri viteve, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me Nenin 7 të kësaj rregulloreje.
4. Evidentimi i kontributeve shkencore të përmendura në këtë nen bëhet sipas pikave të shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen bashkëpunëtor shkencor

1. Në pajtim me nenin 44 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për titullin bashkëpunëtor shkencor (profesorit asistent), në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën doktor shkence (Dr.Sci);
 - 1.1.1. Për gradat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, me rastin e aplikimit për

zgjedhje/rizgjedhje, kandidati duhet të ofrojë dëshminë për nostrifikim nga qendra NARIC në MASHTI.

- 1.2. Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (pedagogjike dhe të edukimit) që dëshmohet;
- 1.3. Të ketë një numër të rëndësishëm të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore:
 - 1.3.1. Më së paku 1 punim të publikuar në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, si autor i parë;
 - 1.3.2. Së paku një monografi shkencore nga fusha përkatëse dhe vëllimet me dokumente, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, akademitë, universitetet dhe botues të regjistruar në organet shtetërore sipas legjislacionit të Kosovës për botuesit;
- 1.4. Të ketë afro një dëshmi për pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 1.5. Të merr pjesë dhe të kontribuojë në projekte kërkimore-shkencore;
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautor i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.3 të këtij neni, vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A, të shtojcës I, të kësaj rregulloreje.
3. Titulli bashkëpunëtor shkencor është me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
4. Bashkëpunëtori shkencor mund të zgjedhet në titull më të lartë, bashkëpunëtor i lartë shkencor, pas katër viteve, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me Nenin 8 të kësaj rregulloreje.
5. Evidentimi i kontributeve shkencore të përmendura në këtë nen bëhet sipas pikave të shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen bashkëpunëtor i lartë shkencor

1. Në pajtim me nenin 44 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për titullin e bashkëpunëtorit të lartë shkencor (profesorit të asociuar), në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktor shkence;
 - 1.1.1. Për gradat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, me rastin e aplikimit për zgjedhje/rizgjedhje, kandidati ofron dëshminë për nostrifikim nga qendra NARIC në MASHTI.
 - 1.2. Të dëshmojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (pedagogjike dhe të edukimit);
 - 1.3. Të ketë një numër të rëndësishëm të monografive, publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare:
 - 1.3.1. Më së paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante

ndërkombëtare nga periudha përkatëse, si autor i parë, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;

- 1.4. Së paku dy monografi shkencore nga fusha përkatëse dhe vëllimet me dokumente, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, akademitë, universitetet dhe botues të regjistruar në organet shtetërore sipas legjislacionit të Kosovës për botuesit, njëra (1) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
- 1.5. Të ketë pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 1.6. Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve shkencore, të cilat janë të udhëhequra nga institucionet shkencore, akademike dhe universitare shtetërore;
- 1.7. Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautor i punimeve të publikuara në revista shkencore, në frymën e pikës 1.3 të këtij neni, vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuara në paragrafin A, të shtojcës I, të kësaj rregulloreje.
3. Titulli bashkëpunëtor i lartë shkencor është me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
4. Bashkëpunëtori i lartë shkencor mund të zgjedhet në titull më të lartë, këshilltar shkencor, pas katër viteve, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara me Nenin 9 të kësaj rregulloreje.
5. Evidentimi i kontributeve shkencore të përmendura në këtë nen bëhet sipas pikave të shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Zgjedhja në thirrjen këshilltar shkencor

1. Ne pajtim me nenin 44 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për titullin e këshilltarit shkencor (profesorit të rregullt), kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën doktor shkence;
 - 1.1.1. Për gradat e fituara jashtë Republikës së Kosovës, me rastin e aplikimit për zgjedhje/rizgjedhje, kandidati ofron dëshminë për nostrifikim nga qendra NARIC në MASHTI.
 - 1.2. Të tregoj nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (pedagogjike dhe të edukimit) që mund të dëshmohet
 - 1.2.1. Më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore të indeksuara ndërkombëtare nga periudha përkatëse, si autor i parë, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
 - 1.2.2. Së paku tri monografi shkencore nga fusha përkatëse dhe vëllimet me dokumente të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, akademitë, universitetet dhe botues të regjistruar në organet shtetërore sipas legjislacionit të Kosovës për botuesit, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
 - 1.2.3. Të ketë pjesëmarrje aktive në konferenca dhe tubime shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - 1.2.4. Përvojë e dëshmuar në projekte të kërkimeve shkencore, të cilat janë të

- udhëhequra nga institucionet shkencore, akademike dhe universitare;
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautor i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.2.1 të këtij neni, vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuara në paragrafin A, të shtojcës I, të kësaj rregulloreje.
 3. Evidentimi i kontributeve shkencore të përmendura në këtë nen bëhet sipas pikave të shtojcave I dhe II të kësaj rregulloreje.
 4. Titulli këshilltar shkencor është i përhershëm.

Neni 10

Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Bashkëpunëtor i jashtëm shkencor është personi fizik që s'është i punësuar i rregullt në ndonjë institucion kërkimor-shkencor dhe profesional, që merret me veprimtari kërkimore-shkencore dhe profesionale, që ka gradën e doktorit të shkencave dhe që ka së paku një (1) punim shkencor të botuar në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm shkencor angazhohen për projekte të caktuara të lidhura me planin e punës së Institutit të cilat nuk mund të realizohen me kapacitetet aktuale njerëzore
3. Angazhimi me kohë të caktuar mund të bëhet edhe në rastet kur:
 - 3.1. Punëtori shkencor merr pozitë udhëheqëse mandatore brenda Institutit;
 - 3.2. Punëtori shkencor merr pozitë mandatore jashtë Institutit, si deputet, ministër, zëvendësministër apo ndonjë pozitë tjetër të ngjashme mandatore në institucionet publike;
 - 3.3. Punëtori shkencor merr pushim pa pagesë për qëllime shëndetësore, avancim profesional apo arsye tjera të lejuara nga Instituti sipas legjislacionit në fuqi;
 - 3.4. Ky angazhim duhet të jetë brenda kufijve të aprovuar buxhetor për periudhën përkatëse kur bëhet angazhimi.
4. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin tituj shkencor në Institut.
5. Punëtorët shkencorë të pensionuar nga Instituti, mund të angazhohen në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm deri në moshën 70 vjeçare, me kërkesë të departamentit, me propozim të drejtorit, si dhe me aprovim nga Këshilli Shkencor dhe Këshilli Drejtues i Institutit.
6. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet me konkurs dhe për një periudhë të caktuar, së paku 6 muaj e më së shumti deri në tri vite.
7. Kontrata për angazhim mund të shkëputet edhe brenda periudhës së vlefshmërisë nëse, për ndonjë arsye, ndryshojnë rrethanat në bazë të cilave është angazhuar bashkëpunëtori shkencor.

Neni 11

Vlerësimi

1. Zgjedhja/rizgjedhja e punëtorëve shkencorë dhe e hulumtuesve bëhet në bazë të konkursit publik.
2. Vlerësimin nëse kandidati i përmbush ose jo kushtet për zgjedhje/rizgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni recensues i emëruar nga Këshilli Shkencor i IPK-së, sipas procedurës së konkursit.

Neni 12

Lidhja dhe shkëputja e marrëdhënies së punës

1. Punëtorët shkencor dhe hulumtuesit lidhin kontratën për punën me Institutin Pedagogjik të Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Kontrata e punës e lidhur midis punëtorit shkencor ose hulumtuesit dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës ose personit tjetër juridik kërkimor-shkencor, shkëputet:
 - 2.1. Me kërkesën e punëtorit shkencor ose të hulumtuesit;
 - 2.2. Në qoftë se punëtori shkencor ose hulumtuesi e humb statusin e punëtorit shkencor, për shkak se nuk zgjedhet ose rizgjedhet në titullin e parapare;
 - 2.3. Në qoftë se punëtori i shkelë detyrat e punës, ose me sjelljet e tij e dëmton autoritetin e IPK-së;
 - 2.4. Në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 13

Kohëzgjatja e zgjedhjes/rizgjedhjes dhe kufizimet

1. Të gjitha zgjedhjet/rizgjedhjet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit, bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit dhe Statutit të IPK-së.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritator për të gjitha pozitat.
3. Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjet shkencore dhe hulumtuese, bëhet sipas renditjes: hulumtues, hulumtues i pavarur, bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor.
4. Zgjedhja/rizgjedhja e parakohshme mund të lejohet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Procedurat e konkursit

1. Procedura e zgjedhjes/rizgjedhjes, duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse në njërin nga gazetatat ditore, në ueb faqen zyrtare të IPK-së dhe SIMBNJ.
2. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (30) ditë kalendarike.

3. Konkursi për zgjedhje dhe rizgjedhje shpallet me vendim të Këshillit Shkencor.
4. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës dhe të kësaj Rregulloreje.
5. Kandidati i cili i ka kryer studimet në universitetet jashtë Kosovës, me rastin e konkurimit për zgjedhje, për cilin do titull, duhet të sjellë vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).
6. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike në adresën zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës, të kërkuara në konkurs.

Neni 15

Komisionet recensuese

1. Instituti Pedagogjik i Kosovës është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë komisionin recensues.
2. Me propozimin dhe aprovimin e pozitës së caktuar, Këshilli Shkencor merr vendim për themelimin dhe zgjedhjen e komisioneve recensuese në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Komisionet recensuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
4. Në komisione recensuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me periudhën përkatëse, për të cilat është shpallur konkursi.
5. Anëtarët e komisionit recensues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati.
6. Anëtari i komisionit recensues me thirrje më të lartë akademike, me automatizëm, është kryetar i komisionit.
7. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të komisionit recensues si në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, në përbërje të komisionit recensues mund të emërohen edhe anëtarë/profesorë nga institucionet tjera shkencore dhe akademike.
8. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë edhe nga institute, akademi dhe universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm, nga Instituti Pedagogjik i Kosovës. Në rastet kur komisioni recensues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm, me automatizëm, është kryetar i komisionit.
9. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 5, 6 dhe 8, anëtarë të komisionit recensues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga fusha përkatëse.
10. Në rast të arsyeve të bazuara, anëtari i komisionit, në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të komisionit recensues, mund të deklaroj me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni. Në këtë rast, drejtori i Institutit, thërret mbledhjen e Këshillit Shkencor dhe në rast të aprovimit të dorëheqjes, kërkon nga Këshilli plotësimin, përkatësisht formimin e komisionit tjetër recensues.
11. Administrata e Institutit duhet t'i ofroj të gjithë dokumentacionin e dorëzuar

komisionit recensues.

12. Kryetari i komisionit recensues, është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe ta hartojë dhe dorëzojë raportin e vlerësimit (recensues) për kandidatet e paraqitur në konkurs.
13. Komisioni recensues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e IPK-së, këtë rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
14. Komisioni recensues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët tjerë. Komisioni duhet të arsyetoj rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.
15. Ne raportin e komisionit recensues duhet të bëhet i qartë propozimi për zgjedhjen apo rizgjedhjen e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatet, të cilët nuk janë zgjedhur.
16. Komisioni recensues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatet, të cilët i plotësojnë kushtet minimale, por të cilët nuk janë propozuar të zgjedhën/rizgjedhën. Për kandidatet të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të cekën kushtet (e parapara në konkurs), të cilat nuk janë plotësuar.
17. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit recensues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për zgjedhje/rizgjedhjen e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një "propozim të ndarë" për Këshillin Shkencor. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në statut dhe të detajuara në këtë rregullore. Në raste të tilla, Këshilli Shkencor diskuton të dy propozimet dhe vendos me shumicë votash për raportin.
18. Këshilli Shkencor i Institutit mban të drejtën të refuzoj propozimet, por nuk mund t'i miratojë të dyja propozimet e ndara për të njëjtën pozitë.
19. Anëtarët e komisionit recensues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë. Në rast se rekomandimet e tyre bien qartazi ndesh me Statutin e/ Institutit dhe këtë rregullore, veprimet e tyre, do të sanksionohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
20. Zyra e administratës së Institutit, është e obliguar që brenda shtatë (7) ditëve pas vendimit të Këshillit Shkencor, të njoftojë kandidatët pjesëmarrës me vendimin e procesit të zgjedhjes/rizgjedhjes.
21. Ndaj vendimit të Këshillit Shkencor, në afat jo më larg se pesëmbëdhjete (15) ditë pas pranimit të njoftimit për vendim, mund të bëhet ankesë në komisionin për ankesa në Institut, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimit në Institut.
22. Kontrata e punës për punonjësin e zgjedhur/rizgjedhur, sipas vendimit të Këshillit Shkencor, do të nënshkruhet vetëm nëse për lëndën përkatëse, brenda afatit ligjor nuk ushtrohet ankesë, respektivisht në rast të ankesës, deri në një vendim përfundimtar të Inspektoratit të Punës.

Neni 16

Zgjedhja e shefit të departamentit dhe shefit të divizionit

1. Veprimtaria e Institutit organizohet sipas departamenteve dhe divizioneve.
2. Departamentet janë njësi themelore nëpërmes të cilave organizohet puna kërkimore-shkencore, profesionale dhe administrative e Institutit.
3. Institutit përbëhet nga dy departamente:
 - 3.1. Departamenti Kërkimor – Shkencor;
 - 3.2. Departamenti për Mbështetje Profesionale – Pedagogjike.
4. Departamenti Kërkimor – Shkencor e përbëhet nga këto divizione:
 - 4.1. Divizioni i kërkimeve në edukim parafillor dhe arsim fillor;
 - 4.2. Divizioni i kërkimeve në arsim të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë;
 - 4.3. Divizioni i kërkimeve në arsim dhe aftësim profesional dhe arsim për të rriturit.
5. Departamenti për mbështetje profesionale-pedagogjike përbëhet nga këto divizione:
 - 5.1. Divizioni për mbështetje të zbatimit të kurrikulës;
 - 5.2. Divizioni për planifikim, zhvillim profesional dhe vlerësim të performancës.
6. Departamentet dhe divizionet udhëhiqen nga shefat përkatës të zgjedhur dhe të emëruar sipas procedurës së përcaktuar me Statutin e Institutit.
7. Shefi i departamentit kërkimor-shkencor dhe departamentit për mbështetje profesionale-pedagogjike përzgjidhen me konkurs të brendshëm, nga një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm të emëruar nga Këshilli Drejtues.
 - 7.1. Mandati i Shefit të Departamentit është katër vjet. I njëjti mund të rizgjidhet edhe për një mandat;
 - 7.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Departamentit janë të përcaktuara me Statutin e Institutit;
 - 7.3. Shefi i Departamentit kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Zgjedhja e shefave të Divizioneve në kuadër të Departamentit kërkimor shkencor dhe Departamentit për mbështetje profesionale-pedagogjike bëhet nga Këshilli Shkencor
 - 8.1. Propozimet për zgjedhjen e shefave të divizioneve i bën drejtori i Institutit;
 - 8.2. Përparësi të zgjedhjes kanë kandidatët e divizionit përkatës, të cilët kanë titullin më të lartë shkencor.
 - 8.3. Shefi i divizionit zgjidhet për katër vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat;
 - 8.4. Detyrat e shefit të divizionit janë të përcaktuara me statutin e Institutit.

Neni 17
Dispozitat kalimtare

1. Kjo Rregullore nuk do të aplikohet për zgjedhjet/rizgjedhjet në thirrjet akademike të fituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Çështjet që nuk janë të rregulluara në mënyrë shprehimore me Statutin e Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK) dhe me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore lidhur me procedurat recensuese për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, rregullohen në dispozitat e kësaj rregulloreje.
- 3.

Neni 18
Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr. sc. Osman Buleshkaj



Shtojca I: FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

A. Autori i parë, autori korrespondent dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare

Në përputhje me Statutin e Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, punimi i publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore, mund të shfrytëzohet për nevoja të zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori korrespondent.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore vlejné përkufizimet vijuese:

- a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;
- b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;
- c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.

A.2. Bazuar në Statutin e IPK-së, Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, këtë rregullore, si dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore gjatë vlerësimit të kandidateve të paraqitur në konkurs, vlejné punimet e publikuara në fushën e kandidatit, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me:

- 1.
- 2.
- 3.

A.2.2. Punimet e publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlefshme me:

- 1.
- 2.
- 3.

A.2.3. Punimet e publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.85:

- 1.
- 2.
- 3.

A.2.4. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.70:

- 1.
- 2.
- 3.

Tabela 1.1. Publikimet në revista që i plotësojnë kushtet si në paragrafët A2.1, A2.2.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit ¹
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2. Publikimet në revista që i plotësojnë kushtet si në paragrafët A2.3.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.3. Publikimet në revista që plotësojnë kushtet si në paragrafët A2.4.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

¹ Komisioni recensues është i obliguar të shënojë linkun, nëpërmjet të cilit dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse të paragrafit A2.1, A2.2, A2.3 dhe A2.4

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN BOTUES NË BOTIMET MONOGRAFIKE SHKENCORE DHE DOKUMENTE TJERA

A. Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente në fushën e kandidatit (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela 1.1. Publikimet e monografive, librave me dokumente, përkthimeve etj., në
gjuhë të huaja.

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2. Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente në gjuhën
shqipe.

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

B. Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela 1.1. Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore
në nivel ndërkombëtar jashtë vendit).

Nr.	Autori/autoret	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2. Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor.

Nr.	Autori/Autoret	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

C. Aktivitetet tjetra kërkimore shkencore

Tabela 1.1. Prezantimet në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit.

Nr.	Autori/autorët/ prezantuesi	Titulli i kumtesës	Emri i konferencës, simpoziumit, organizatori	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.2. Kryeredaktor, redaktor shkencor, redaktor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje.

Nr.	Kontributi (redaktor, recensues...)	Autori origjinal i librit	Titulli i librit	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.3. Redaktor, recensues, anëtar redaksie në revista akademike dhe shkencore.

Nr.	Kontributi (redaktor, recensues...)	Autori origjinal i librit	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.4. Kontribute tjera shkencore dhe profesionale.

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencor	Vendi dhe viti
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

D.Kontribute në projekte të kërkimeve shkencore

Tabela 1.1. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore.

Nr.	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Pozicioni në projekt	Institucioni dhe vendi
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				